

SITUATA ME TË DREJTAT E NJERIUT – RAPORT MUJOR



PRILL

20

25

SITUATA ME TË DREJTAT E NJERIUT – RAPORT MUJOR

Kjo botim u financua nga Bashkimi Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Shkup dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.



PËRMBAJTJA

01

Hyrje

02

Gjuha e urrejtjes

03

Veprat nga urrejtja

04

**Dhuna në bazë
gjinore dhe dhuna në
familje**

05

Institucione të mbyllura

06

Ndihmë juridike falas

HYRJE

Në fillim të prillit, Platforma për Barazi Gjinore dhe Rrjeti për Mbrojtje nga Diskriminimi reaguan ashpër ndaj ndryshimeve dhe plotësimeve në Ligjin për arsimin fillor dhe Ligjin për tekstet shkollore për arsimin fillor dhe të mesëm, të cilat legalizojnë diskriminimin dhe dhunën, dhe fshijnë temat e shëndetit seksual dhe riprodhues dhe barazisë gjinore. Këto ndryshime ligjore u miratuan pa konsultime me të rinjtë dhe komunitetin profesional dhe janë drejtpërdrejt në kundërshtim me nevojat e të rinjve. Platforma për Barazi Gjinore dhe Rrjeti për Mbrojtje nga Diskriminimi, ndër të tjera, i kërkuan Presidentit të vendit të mos nënshkruajë dekretet për miratimin e ligjeve, si dhe Qeverisë dhe Parlamentit të rishqyrtojnë ligjet e fushës së arsimit që dëmtojnë drejtpërdrejt shëndetin e të rinjve. Ato kërkuan gjithashtu që të mbahet një seancë mbikëqyrëse mbi sfidat dhe pengesat në zbatimin e Ligjit për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi para Komisionit të Përhershëm Hetimor për Mbrojtjen e Lirive dhe të Drejtave të Qytetarëve.

HYRJE

Ata kërkuan gjithashtu që të hapet një debat i gjerë me të rinjtë, organizatat rinore dhe organizatat profesionale shëndetësore që punojnë për mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve të marginalizuara dhe përgatitjen e ndryshimeve në Ligjin për arsimin fillor, Ligjin për arsimin e mesëm dhe Ligjin për tekstet shkollore për arsimin fillor dhe të mesëm, të bazuara në prova dhe shkencë, dhe në përputhje me dokumentet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, të cilat në thelb do të tregojnë kujdesin e vërtetë për të rinjtë, si dhe zbatimin urgjent dhe të menjëhershëm të akteve nënligjore për mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna dhe diskriminimi në shkolla.

Pas miratimit të këtyre ndryshimeve në Kuvend, Platforma për Barazi Gjinore dhe Rrjeti për Mbrojtjen nga Diskriminimi i bënë thirrje publike Presidentes së shtetit që të mos nënshkruajë dekretet për ndryshimet dhe plotësimet në Ligjin për arsimin fillor dhe Ligjin për tekstet shkollore për arsimin fillor dhe të mesëm. Ajo ka firmosur dekretet dhe nuk ka nisur debat.

HYRJE

Më 2 prill 2025, në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut u mbajt seanca e 24-të e Komisionit për Zgjedhje dhe Emërime, në të cilën u miratua një propozim-vendim për zgjedhjen e anëtarit të Komisionit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi më pak se 24 orë pas mbajtjes së seancës publike dëgjimore. Komisioni i Zgjedhjeve dhe Emërimeve u propozoi anëtarëve të Kuvendit Vecko Zdraveskin si komisioner të ardhshëm me mandat pesëvjeçar, një kandidat që është kuadër partiak dhe nuk i plotëson kriteret e përzgjedhjes. Rrjeti për Mbrojtje nga Diskriminimi kërkoi që Kuvendi të mos e pranonte këtë propozim dhe të mos votonte për këtë kandidat si anëtar të ardhshëm të KPMD-së.

Rrjeti për Mbrojtje nga Diskriminimi theksoi se zgjedhja e këtij kandidati për anëtar të KPMD-së jo vetëm që nuk është në shërbim të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, por do të ishte edhe e dëmshme për të drejtat e njeriut, barazinë dhe mosdiskriminimin. Intervista e zhvilluar me kandidatin, prezantimi i tij dhe veçanërisht përgjigjet ndaj pyetjeve nga publiku ishin në një nivel të pakënaqshëm sipas të gjitha standardeve për zgjedhjen e një anëtari të organit të barazisë. Intervista e tij tregon qartë se kandidati nuk ndihet i sigurt kur shqipton disa nga bazat e diskriminimit, siç janë, për shembull, fjalët "orientim seksual" dhe "grua trans".

HYRJE

Një qëndrim i tillë tregon një mungesë të plotë respekti për komunitetet e marginalizuara, të cilat janë gjithashtu disa nga personat më të diskriminuar, dhe krijon dyshime reale se nëse ai do të ishte anëtar i KPMD-së, kandidati do të vepronte në mënyrë të paanshme dhe profesionale ndaj të gjithë qytetarëve. Nga ana tjetër, është plotësisht e paqartë se si Komisioni përcaktoi se kandidati i plotëson kriteret ligjore dhe është ekspert në parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi, kur nuk kishte më shumë se 10% të numrit të përgjithshëm të anëtarëve në Kuvend në seancë, ndërsa biografia e tij nuk tregon një ekspertizë të tillë, madje edhe interes.

Dita Ndërkombëtare e Romëve u shënua më 8 prill, por, sipas Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, nuk është bërë asnjë përparim në luftën kundër diskriminimit ndaj romëve në vend. Komiteti i Helsinkit regjistron gjuhë urrejtjeje dhe gjuhë ngacmuese kundër anëtarëve të komunitetit rom pothuajse çdo muaj.

HYRJE

Romët përballen me diskriminim të shumëfishtë dhe kjo shihet më së shumti në qëndrimin e institucioneve ndaj tyre, por edhe në trajtimin që ata marrin nga shoqëria në tërësi. Romët mbeten komuniteti më i rrezikuar dhe ekonomikisht më i prekshëm në vend, dhe ka shenja shqetësuese të stigmatizimit dhe paragjykit.

-

Në prill, Platforma për Barazi Gjinore dhe Rrjeti për Mbrojtje nga Diskriminimi reaguesh për ndaj miratimit të ligjit të tretë të dëmshëm radhazi në fushën e arsimit - Ligjit për arsimin e mesëm. Ndryshimet në ligje legalizojnë dhunën dhe diskriminimin ndaj fëmijëve, dhe të rinjtë mbeten pa qasje në arsim shëndetësor të bazuar në prova. Pavarësisht apeleve të sektorit të shoqërisë civile, Presidentja nënshkroi dekretin për këto ndryshime të Ligjit për arsimin e mesëm.

Platforma për Barazi Gjinore, pas gjykimit kundër 36-vjeçares Vangjelica nga Kratova, e cila është viktimë e dhunës në familje dhe të cilën Prokuroria Themelore Publike po e ndjek penalisht për veprën penale "vrasje me dashje", kërkoj nga Prokuroria Publike në Kumanovë që ta rikualifikojë veprën penale në "vetëmbrojtje", ndërsa nga Gjykata që të veprojë me kujdesin e duhur në këtë rast dhe të shqyrtojë të gjitha faktet vendimtare dhe të marrë parasysh parimet e përcaktuara me vendimin lirues në rastin e Pale Iliovska nga Velesi.

HYRJE

Rrjeti për Mbrojtje nga Diskriminimi në muajin prill kërkoi tërheqjen e vendimit të Qeverisë për emërimin e Petar Bogojeskit si Drejtor të Agjencisë Kombëtare për Programe Arsimore Evropiane dhe Lëvizshmëri për shkak të deklaratave të tij që përmbanin gjuhë shqetësuese, fyerje dhe gjuhë urrejtjeje, si dhe veprime që janë në kundërshtim me vlerat evropiane.

Platforma e Organizatave të Shoqërisë Civile për Luftën kundër Korrupsionit reagoi në lidhje me rekomandimet e Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK) në kuadër të rishikimit anti-korrupsion të Ligjit për qasje të lirë në informacion publik.

Në vend që të kontribuojë në një transparencë, llogaridhënie dhe luftë më të madhe kundër korrupsionit, KSHPK-ja, përmes indikacioneve të saj të supozuara për "rreziqe rregullatore", dërgon sinjale seriozisht shqetësuese për mbylljen e institucioneve dhe krijon mundësi për kufizimin e të drejtës së publikut për të marrë informacion. Platforma beson se rekomandime të tilla jo vetëm që minojnë rolin e KSHPK-së si një institucion kyç për parandalimin e korrupsionit, por gjithashtu hapin drejtpërdrejt hapësirë për abuzime të reja korruptive, veçanërisht në fushën e prokurimeve publike.


SITUATA ME GJUHËN E URREJTJES NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT, RAPORT MUJOR - PRILL 2025

Gjatë muajit prill në ueb platformën www.govornaomraza.mk janë regjistruar gjithsej 19 raste me elemente të gjuhës së urrejtjes, thirrjes dhe nxitjes së diskriminimit dhe ngacmimit mbi baza të ndryshme.

Këtë muaj janë regjistruar 12 raste (43%) të gjuhës së urrejtjes në bazë të nacionalitetit (kombësisë), 8 raste (29%) në bazë të përkatësisë etnike, 3 raste (11%) në bazë të përkatësisë politike, 3 raste (11%) në bazë të gjinisë dhe seksit dhe 2 raste (7%) në bazë të religjionit dhe bindjeve religjioze.

Trendi shqetësues i një numri në rritje të raportimeve që lidhen me përkatësinë kombëtare dhe etnike vazhdoi edhe gjatë muajit prill. Në rrjetet sociale, vërehet përmbajtje fyese dhe përçmuese e drejtuar ndaj komuniteteve të ndryshme etnike, shpesh e vendosur në një kontekst më të gjerë socio-politik. Kjo formë e gjuhës së urrejtjes kontribuon në krijimin e një mjedisi publik armiqësor dhe të polarizuar.

PARAQITJA GRAFIKE E SITUATËS ME GJUHËN E URREJTJES NË PRILL TË VITIT 2025



Platforma regjistroi 19 raste origjinale të gjuhës së urrejtjes - në disa raste, u regjistruan më shumë se një karakteristikë mbrojtëse.

SITUATA ME GJUHËN E URREJTJES NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT, RAPORT MUJOR - PRILL 2025

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIM

Përfundim:

Vazhdimi i këtij trendi tregon nevojën për një përgjigje të koordinuar dhe vendimtare nga të gjithë aktorët përkatës - institucionet, organizatat e shoqërisë civile, media dhe publiku i gjerë - me qëllim mbrojtjen e kohezionit shoqëror.

-

Rekomandim:

Nevojitet një monitorim i përforcuar institucional i këtyre fenomeneve, si dhe një rol më aktiv i të gjithë aktorëve. Përveç kësaj, ne rekomandojmë zbatimin e fushatave publike për edukimin dhe promovimin e dialogut dhe mirëkuptimit ndërkulturor, me theks të veçantë tek të rinjtë.

SITUATA ME VEPRAT NGA URREJTJA NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT, RAPORT MUJOR - PRILL 2025

Gjatë muajit prill 2025, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut ka regjistruar 9 incidente të mundshme me motive të njëanshme, në pjesën më të madhe, në përputhje me treguesit e tjerë (vendndodhja, mënyra e ekzekutimit, përfshirja e të miturve dhe nxënësve të shkollave të mesme etj.), ekziston bindja e arsyeshme se ato janë kryer për shkak të përkatësisë etnike të viktimës, gjegjësisht autorit. Konkretisht, po flasim për 3 incidente të mundshme bazuar në përkatësinë etnike dhe 5 incidente bazuar në besimin fetar dhe 1 incident në bazë të përkatësisë kombëtare. Sipas llojit të dhunës, 3 nga incidentet përmbajnë dhunë. kurse 6 prej tyre përdhosje të simboleve. Në dy nga rastet, të miturit shfaqen si viktima ose autorë.

Incidentet e mundshme janë përfshirë në raport sepse ato lidhen me situata ku tregues të tjerë sugjerojnë se ka arsye për të besuar se këto incidente janë të motivuara nga njëanshmëria. Ndër këta tregues të njëanshëm janë: perceptimi i viktimës/dëshmitarit; komentimi në vendin e ngjarjes; dallimi ndërmjet viktimës dhe dhunuesit në bazë etnike; modeli/frekuenca e incidenteve të mëparshme; natyra e dhunës; mungesa e motiveve të tjera; si dhe vendi dhe koha.

SITUATA ME VEPRAT NGA URREJTJA NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT, RAPORT MUJOR - PRILL 2025

Thënë më saktë, incidentet e mundshme janë përfshirë në këtë raport për shkak të informacionit të marrë në lidhje me vendndodhjen (shembull: lagje ose shkolla etnikisht e përzier, linjat e autobusëve të përdorura nga anëtarë të komuniteteve të ndryshme etnike, vendet ku në të kaluarën kanë ndodhur vepra penale të urrejtjes), llojin (shembull: një grup më i madh në numër i personave të mitur që sulmojnë një ose më shumë viktima pa ndonjë provokim, përleshje grupore, sulme të mëparshme në autobus apo stacion autobusi), koha (shembull: pas përplasjeve të mparshme si formë hakmarrjeje, pas lëshimit nga shkolla, gjatë ose pas një ndeshjeje sportive), dhe prona e dëmtuar gjatë kohës së incidentit (shembull: vendet e ceremonive fetare).

SITUATA ME VEPRAT NGA URREJTJA NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT, RAPORT MUJOR - PRILL 2025

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIM

Përfundime:

1. Ka një dukuri të vazhdueshme të incidenteve me motive të njëanshme, ku si motiv dominon kryesisht përkatësia etnike, me përfshirjen e të miturve dhe nxënësve të shkollave të mesme si viktima apo autorë.
2. Incidentet po ndodhin në vende që më parë janë identifikuar si pika rreziku, siç janë lagjet etnikisht të përziera, shkollat dhe transporti publik, duke treguar nevojën për vëmendje të veçantë për këto zona.

Rekomandime:

- Është e nevojshme të forcohen programet parandaluese dhe aktivitetet edukative në shkolla dhe komunitete me etni të larmishme, me qëllim ndërtimin e dialogut ndërkulturor, tolerancës dhe komunikimit jo të dhunshëm midis të rinjve.
- Është e nevojshme të krijohen mekanizma të përforcuar për monitorim dhe ndërhyrje të shpejtë në zonat e rrezikut përmes rritjes së bashkëpunimit midis policisë, shkollave, qeverisjes vendore dhe organizatave të shoqërisë civile.

SITUATA ME DHUNËN ME BAZË GJINORE DHE DHUNËN NË FAMILJE, RAPORT MUJOR - PRILL 2025

Gjatë këtij muaji, dy viktima të dhunës në familje iu drejtuan Komitetit të Helsinkit në lidhje me raste që lidhen me ushtrimin e të drejtave prindërore dhe mbrojtjen e interesave më të mira të fëmijës.

Në rastin e parë, babai kërkoi një zgjatje të konsiderueshme të orarit të vizitave me fëmijën e tij nga datat e përcaktuara më parë, duke përfshirë qëndrime shumëditore dhe të zgjatura. Nëna, së cilës i është besuar fëmija i mitur, tregoi se orari i propozuar i vizitave prish seriozisht rritjen dhe zhvillimin e duhur emocional të fëmijës, i cili është në një moshë shumë të re. Përveç kësaj, ajo shprehu shqetësim për ndikimin që mund të ketë ndarja nga nëna, si dhe për përfshirjen e pamjaftueshme të babait në kujdesin e drejtpërdrejtë gjatë vizitave.

Në rastin e dytë, një fëmijë me gjendje të rëndë shëndetësore iu nënshtrua një ndërhyrjeje kirurgjikale në një nga spitalet private vendase. Nëna na informoi se babai nuk lejonte trajtimin në kohë dhe pengonte shtrimin në spital për arsye financiare, ndërsa në të njëjtën kohë refuzonte t'i jepte fëmijës terapinë e duhur. Pavarësisht rekomandimeve të mjekëve mbi domosdoshmërinë që fëmija të ishte nën kujdesin e drejtpërdrejtë të nënës pas ndërhyrjes kirurgjikale, babai nuk pranoi, duke ua lënë kujdesin e fëmijës anëtarëve të tjerë të familjes.

SITUATA ME DHUNËN ME BAZË GJINORE DHE DHUNËN NË FAMILJE, RAPORT MUJOR - PRILL 2025

Në të dyja rastet, mosmarrëveshjet prindërore dhe vendimet institucionale ndikojnë drejtpërdrejt në stabilitetin psikofizik të fëmijëve, ku respektimi i rreptë i parimit të interesit më të mirë të fëmijës është veçanërisht i rëndësishëm në vendimmarrje.

SITUATA ME DHUNËN ME BAZË GJINORE DHE DHUNËN NË FAMILJE, RAPORT MUJOR - PRILL 2025

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIM

Përfundime:

- Ekziston nevoja për një vlerësim më gjithëpërfshirës të nevojave të zhvillimit psikologjik dhe emocional të fëmijëve, kur përcaktohen marrëdhëniet personale me prindërit.
- Në procedurat e vizitave, institucionet shpesh përballen me vështirësi në balancimin e të drejtave të prindërve dhe interesave më të mira të fëmijës, veçanërisht në rastet me elementë shëndetësorë dhe zhvillimorë.

Rekomandime:

- Kur marrin vendime në lidhje me vizitat, qendrat e punës sociale duhet të kryejnë një vlerësim të plotë multidisiplinar që përfshin ekspertë në fushat e pediatriisë, psikologjisë dhe trajtimit zhvillimor.
- Është e nevojshme të ofrohet trajnim i vazhdueshëm për shërbimet profesionale mbi zbatimin e standardeve për vlerësimin e interesave më të mira të fëmijës, veçanërisht në rastet e ndjeshme dhe komplekse.

SITUATA ME INSTITUCIONET E MBYLLURA

Pasqyrë e përgjithshme e aktiviteteve

Gjatë muajit prill 2025, Komiteti i Helsinkit ka ofruar ndihmë juridike falas për personat e dënuar në shtatë raste.

Dy raste: Lirim me kusht me mbikëqyrje mbrojtëse

Një rast: Tortura dhe trajtim çnjerëzor

Një rast: Arrest shtëpiak

Një rast: Vizita në burg

Dy raste: Mbrojtja e shëndetit dhe siguria e një personi të dënuar

Pasqyrë e shkurtër e shërbimeve juridike të ofruara

- Rishikimi i legjislacionit dhe këshillave ligjore të ofruara mbi lirin me kusht me mbikëqyrje mbrojtëse për të burgosurit dhe familjarët e tyre.
- Kërkesa për qasje të lirë në informacione dorëzuar institucioneve kompetente.
- Ofrimi i informacionit dhe këshillave ligjore për klientët.

SITUATA ME INSTITUCIONET E MBYLLURA

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIM

Përfundime dhe rekomandime:

- **Është e nevojshme të merren në konsideratë nevojat specifike të secilit të dënuar, veçanërisht në rastet kur merren vendime për lirim me kusht me mbikëqyrje mbrojtëse si një masë pozitive për të ulur mbipopullimin e burgjeve.**
- **Është e nevojshme të përmirësohen kushtet për kujdesin mjekësor duke siguruar personel mjekësor të kualifikuar, kontrole të rregullta shëndetësore dhe mekanizma efikasë për raportimin dhe zgjidhjen e problemeve shëndetësore.**
- **Është e nevojshme të forcohen mekanizmat e mbikëqyrjes dhe llogaridhënies në institucionet ndëshkimore-korrektuese me qëllim promovimin e respektit për të drejtat e njeriut dhe aksesin në drejtësi për personat e dënuar.**

NDIHMË JURIDIKE FALAS,

RAPORT MUJOR - PRILL 2025

TË DHËNA STATISTIKORE

NJF	32	
NDJ	1	
Gjithsej	33	
	Numri	Përqindja
Gjinia		
Meshkuj	18	54.5
Femra	15	45.5
Përkatësia etnike		
Maqedonë	27	82
Shqiptarë	6	18
Romë	0	0
Të tjerë	0	0
Rajonet gjeografike		
Shkup	24	73
Vardar	1	3
Pollog	0	0
Pellagoni	1	3
Jugperëndim	2	6
Verilindje	2	6
Lindje	2	6
Juglindje	1	3

NDIHMË JURIDIKE FALAS, RAPORT MUJOR – PRILL 2025 TË DHËNA STATISTIKORE

Fusha juridike	Numri	Përqindja
E drejta pronësore	4	12
Mbrojtja dhe sigurimi social	2	6
Mbrojtja e fëmijëve	2	6
Sigurimi pensional dhe invalidor	0	0
Mbrojtja dhe sigurimi shëndetësor	1	3
Marrëdhëniet e punës	3	9
Dhuna me bazë gjinore dhe dhuna në familje	3	9
Çështje statusore	3	9
Mbrojtja e të drejtave të njeriut	10	30,5
Të tjera	5	15,5

RAST STUDIMI PËR APROVIMIN E NDIHMËS JURIDIKE DYTËSORE (NJD) - KONTEST ADMINISTRATIV NË FUSHËN E MBROJTJES SOCIALE

Një qytetar nga Shkupi, kërkesa e të cilit për realizimin e të drejtës së sigurimit social për të moshuarit u refuzua nga Qendra për Punë Sociale për shkak se ai zotëronte një automjet, iu drejtua Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut me një kërkesë për ndihmë juridike falas. Megjithatë, procedura e përgjithshme administrative për këtë të drejtë filloi shumë më herët (në vitin 2022), duke pasur parasysh se organi i shkallës së dytë dikur e pranoi ankesën e aplikantit dhe e anuloi vendimin e Qendrës për Punë Sociale - Shkup. Gjegjësisht, që nga dita kur u pranua ankesa e aplikantit, përkatësisht kur u vu re (duke cituar nene nga Rregullorja) se një automjet i regjistruar pasagjerësh nuk konsiderohet pronë nëse përdoret për transportin e një personi me aftësi të kufizuara, deri më sot - rrethanat nuk kanë ndryshuar, përkatësisht aplikantit i nevojitet automjeti për nevojat e transportit të djalit të tij me paralizë cerebrale infantile. Dhe pikërisht posedimi i atij automjeti është arsyeja e vetme pse kërkesa e tij për ushtrimin e të drejtës së sigurimit social për të moshuarit u refuzua, pa shpjegimin e nevojshëm të kërkuar nga neni 88 i Ligjit të Procedurës Administrative. Është për këto arsye që Komiteti i Helsinkit paraqiti një kërkesë për miratim nga Zyra e Prokurorit Publik për të emëruar një avokat për të përfaqësuar aplikantin në seancën kryesore publike para Gjykatës Administrative.

RAST STUDIMI PËR APROVIMIN E NDIHMËS JURIDIKE DYTËSORE (NJD) - KONTEST ADMINISTRATIV NË FUSHËN E MBROJTJES SOCIALE

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIM

Në fushën e realizimit të të drejtave në mbrojtje sociale është e nevojshme konsistencë dhe urgjencë më e madhe në marrjen e vendimeve brenda procedurës së përgjithshme administrative.

Për sa i përket konsistencës, vihet re se autoriteti i shkallës së parë (në këtë rast Qendra për Punë Sociale), pasi është pranuar ankesa e kërkuarit, nuk ka marrë parasysh udhëzimet e autoritetit të shkallës së dytë (në këtë rast, Komisionit Shtetëror për vendimmarrje në shkallën e dytë) gjatë marrjes së vendimit të ri.

Sa i përket shpejtësisë/veprimit në kohë, duhet të kihet parasysh se pretendentët e të drejtave të mbrojtjes sociale janë qytetarë në rrezik serioz social, dhe për këtë arsye është e nevojshme që institucionet shtetërore, veçanërisht në këto raste, të veprojnë në përputhje me afatet e përcaktuara ligjore. Domethënë, mungesa e shpejtësisë në zgjidhjen e rasteve më së shpeshti ndodh tek autoritetet e paditura të shkallës së parë, të cilat nuk veprojnë brenda afatit të përcaktuar me ligj kur çështja u kthehet atyre për rivendosje, pavarësisht nëse ajo kthehet pas një anese të pranuar në kuadër të procedurës së përgjithshme administrative apo pas një padie të pranuar në kuadër të mosmarrëveshjes administrative.